



Në kuadër të Marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, në Istanbul Technical University (ITU), Turqi

Llojet e mobilitetit përfshijnë: Shkëmbimin e studentëve për studime, praktikë mësimore, aktivitete kërkimore ose studimore për kandidatët e doktoraturës)

Nivelet e mobilitetit për studentët: Studentët duhet të jenë të regjistruar në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe të kenë përfunduar vitin e parë të studimeve.

Llojet dhe kohëzgjatja e bursave për studentët: Semestri i parë i vitit akademik 2026 - 2027

- **Mobilitete për studime (SMS): 5 muaj**
- **Mobilitete për praktikë mësimore SMP): 2–5 muaj (përfshirë aktivitetet kërkimore)**
- **Mobiliteti i Doktoraturës Afatshkurtër: 5–30 ditë (aktivitete kërkimore ose studimore për kandidatët e doktoraturës)**

Numri total i studentëve: 3 (Nominimi përfundimtar kryhet nga ITU)

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj* (Anglisht);
- Dokumenti Learning Agreement**.



Key Action 1
– Mobility for learners –

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B1. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj. Preferohen: TOEFL IBT Certificate, Cambridge Certificate, IELTS Certificate.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Mobility Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kurju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në ITU lëndët e njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohenit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” te seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga Përgjegjësi i Departamentit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për t’u njohur me programin e lëndëve që ofron ITU, ju lutemi klikoni te:

<https://erasmus-plus.ec.europa.eu/document/erasmus-international-credit-mobility>

[ITÜ | Programs](#)

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: Deri më 20 maj 2026, ora 12.00

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al dhe abeqo@upt.al